



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202400606/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Fier.*

**Drejtuar:** **Z. Erdit RECEKU**  
Shef i Komisariatit të Policisë

**FIER**

**Për dijëni:** **Z. Lorenc PANGANIKA**  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

**FIER**

**Për dijëni:** **Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Fier nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Fier.

Inspektimi u krye në datën 09.05.2024, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej z. Hazbi Selita, znj. Lindita Dedëgjoni, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

MKPT, bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të emigrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria, azilkërkuesit, institucionet psikiatrike dhe shtëpitë e të moshuarve.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurës standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në Mjediset e Policisë*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit, u takua me Drejtorin e Policisë z. Lorenc Panganika dhe Shefin e Komisarariatit z. Erdit Receku, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushtet, në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisarariat dhe informoi për masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar<sup>1</sup>, në lidhje me përmirësimin e disa kushteve sipas normave dhe standardeve, për qëndrimin dhe trajtimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ndërkombëtare dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilat janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimin e kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat

---

<sup>1</sup> Shkresë Nr.K4/I33-2, Prot., datë 09.03.2023 “Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Fier”.

që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve e ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/arrestuar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona.

Nisur nga informacioni i drejtuesve të policisë, por dhe nga inspektimi i kryer në mjediset e sigurisë dhe të shoqërimit në këtë drejtori, rezultoi se respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kushtet infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në tërësi ishin sipas kritereve, normave dhe parametrave teknikë të parashikuara në procedurat standarde, që garantojnë sigurinë dhe trajtimin e këtyre personave.

Nga informacioni dhe verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në përfundim të inspektimit të kryer në vitin 2023<sup>2</sup>, rezulton se:

1. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për vënien në funksion të ambientit të dusheve për dhomat e sigurisë në këtë komisariat, pasi ishte përshtatur një ambient ekzistues brenda godinës së dhomave të sigurisë dhe ishin instaluar dushet dhe pajisjet e tjera të cilat shërbejnë për larjen e trupit të personave të ndaluar/arrestuar, por në ditën e inspektimit nuk ishin në funksion për shkak të lidhjeve të tyre me tubacionin e ujit dhe energjinë elektrike.
2. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për dezinfektimin e vazhdueshëm të ambienteve të këtij komisariati dhe në veçanti ambienti i dhomave të shoqërimit, por kishte nevojë për lyerje.
3. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera sigurie në korridoret e ambientit të shoqërimit, por jo brenda dhomave të shoqërimit.
4. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit duke i adresuar ato Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

**Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:**

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për emërimin e mjekut me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar, brenda 12 orëve të vendosjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës së mjekut brenda ambienteve të dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë Fier.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në to.

---

<sup>2</sup> Kthim përgjigje të rekomandimit tonë me numër 7141/1 prot, datë 15.09.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për vënien në funksion të kaldajës për mundësimin e ngrohjes së personave të arrestuar, për periudhën e dimrit në ambientin e dhomave të sigurisë në këtë komisariat.
7. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për drejtuesit e komisariatit për nxjerrjen e përgjegjësive për mos zbatimin e rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, dhe komunikimin në vijim të masave të marra në lidhje me to.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësia vendore, por çdo komisariat duhet të demonstrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve, njëkohësisht vërejmë me keqardhje të thellë se disa të tjera lidhen me qasjen bashkëpunuese të drejtuesve ndaj rekomandimeve, ndonëse të pranuar dhe të përsëritura disa herë nga ana jonë.

Ndërkohë ka edhe rekomandime që kanë ndikim të qenësishëm në jetën e të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve të cilat nuk kanë asnjë implikim buxhetor, dhe për pasojë moszbatimi i këtyre të fundit është i pajustificueshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Fier, ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhërin nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në godinë më vete, brenda territorit të komisariatit dhe përbëhej nga tre dhoma shoqërimi të ndërtuara për persona të rritur, gra dhe për të miturit<sup>3</sup>.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve. Ato ishin të pajisura secila me 3 karrige të fiksuara në dysheme, që mundësonin qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, si dhe ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por mungonin tavolina për qëndrimin e personave në konflikt me ligjin në këto ambiente. Të 3 dhomat e shoqërimit kishin tualete brenda, të pajisura me çezmë, që kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Përmasat e dhomës së shoqërimit ishin 4x4 m2, me kapacitet deri në 12 persona të shoqëruar.

---

<sup>3</sup> Kreu VII, pika 4/d e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Dritaret e dhomave të shoqërimit janë me përmasa të tilla, që mundësojnë ajrim dhe ndriçim natyral të plotë. Në pjesën e jashtme, ato janë të siguruara me skarë me qëllim sigurimin e personave të shoqëruar, por mungonte kanata e dritares në njërin nga dhomat, e cila ishte vetëm me skarë hekuri. Ndërsa të tjerat ishin me kanata por kishin xhamat e thyer, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se: *“Dritaret e dhomave të shoqërimit të jenë me përmasa jo më pak se 1.5 x 1.2 m”, dhe nga ana e jashtme e dritareve të jetë e vendosur një zgarë hekuri me shufra vertikale dhe horizontale me trashësi/seksion 18 mm dhe me kuadrate 15 x15 cm, të fikësuara në faqen anësore të dritares. Dritaret duhet të jenë me material duralumin dhe dopjo xham<sup>4</sup>”*. Ambientet e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Dhomat e shoqërimit kanë ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik, si dhe gjenerator që shërben si burim rezervë në rast ndërprerje të energjisë elektrike.

Dyert e dhomave të shoqërimit mbyllen me çelës dhe kanë bravë të rregullt por nuk plotësonin standardin e parashikuar në kreun VI pika 4, gërma “e.6.4” e procedurës standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, ku parashikon se: *“Në pjesën e sipërme të dyerve duhet të krijohet një hapësirë me përmasa 60 x 40 cm, në të cilën montohet një xham transparent dhe i armuar (i pa çmontueshëm dhe rezistent/i pathyeshëm ndaj goditjeve me grushte, shkelma, kokë). Hapësira e dritares/sportelit të derës nga ana e korridorit të dhomave sigurohet me një rrjetë teli me shufra me seksion/trashësi 0,6 mm të cilat vendosen në mënyrë vertikale dhe horizontale duke krijuar kuadrate 5 x 5 cm.*

Në koridoret e dhomave të shoqërimit ishin të instaluar 2 kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti, por ato mungonin brenda dhomave të shoqërimit për monitorimin e personave të shoqëruar në këtë insitucion. Instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë brenda dhomave të shoqërimit do të shërbejë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, si dhe do të monitorojë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimit në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre.

Në kushtet e vendodhjes së komisariatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku thuhet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përjashto tualetin) si ambientet e brendshëm i dhomave të shoqërimit, korridorit i tyre dhe pjesën e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe*

---

<sup>4</sup> Kreu VI pika 4 gërma e.8, e.9 e procedurave standarde të punës “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

*trasmendojnë pamje/imagje në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit DPV komisaritate, stacione policise”, konstatim i përsëritur edhe nga inspektimi i mëparshëm nga Institucioni i Avokatit të Popullit.*

Në ambientin e shoqërimit në korridor, ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Në Komisariatin e Policisë Fier, gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 10.05.2024 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **525** persona, ku konkretisht 511 persona ishin shtetas madhorë, 6 shtetase gra dhe 8 shtetas të mitur në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** të shoqëruar në dhomat e shoqërimit.

Nga inspektimi i ambientit të shoqërimit u konstatua se, mungonte dhoma e veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, e cila duhet të jetë e pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë<sup>5</sup>, por sipas informacionit të Shefit të Rendit, të shoqëruarit merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Gjithashtu, përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia **nuk ju jepej informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë.** Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarimat<sup>6</sup>. Rekomandimi i CPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, **duhet tu jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit**, pra që në momentet e para të privimit të lirisë, Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 10 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj. Aktualisht, karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluar/arrestuari merret në pyetje nga OPGJ dhe hyn në dhomat e sigurisë.

Në strukturën organike të Komisariatit të Policisë Fier janë 8 specialistë policie, që kryejnë funksionin e OPGJ-së për rastet e hetimit të veprave të rënda penale dhe njëkohësisht ata kryejnë veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar. Në këtë institucion kishte 7 zyra pune të OPGJ-ve dhe nga inspektimi i këtyre zyrave, nuk u gjendën sende apo mjete që ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre.

---

<sup>5</sup> Kreu VI, Pika 3/d e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin Nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>6</sup> Raporti i Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018.

Gjithashtu, në katin e parë të Komisarariatit të Policisë Fier, ndodhej një dhomë e cila shërbente si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ). Ky ambient ishte i pajisur me tavolinë, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit<sup>7</sup>.

Në Komisariatin e Policisë Fier, në katin e dytë të institucionit ishte një dhomë e mbajtjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisarariatit provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient.

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Fier, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej, një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

### **Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Fier ishin **pjesërisht** të ndërtuara, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurat standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambientet e sigurisë përbëheshin nga 6 dhoma sigurie me kapacitet zyrtar për 8 persona, konkretisht 4 (katër) dhoma me nga 1 (një) person secila, ndërsa 2 (dy) dhoma të tjera me 2 persona, të ndara në dhoma për të rritur, në dhoma për femra dhe në dhoma për të mitur, sipas kërkesës së ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktit të procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.1720, datë 20.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshin 3 (tre) persona, në cilësinë e të arrestuarit dhe të ndaluarit.

Ambientet e dhomave të sigurisë ndahen në dy pjesë, në ambientin për jetesë, si dhe në paradhomenë që shërbente për qëndrimin e personave në orare të caktuara dhe për pastrim vetjak, pasi ndodhej çezma me lavaman. Ndërkohë 4 (katër) prej dhomave ishin të pajisura me nga 1 (një) shtrat me krevat, ndërsa 2 (dy) të tjerat nga 2 (dy) shtretër me 2 (dy) krevate.

Të 4 dhomat e sigurisë të pajisura me nga një shtrat me krevat, i plotësonin normat dhe parametrat teknik jetësor, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme

---

<sup>7</sup> Kreu VI, Pika 4/g e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

ishite jo më pak se 10 m<sup>2</sup>, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.

Ndërsa dy dhomat të tjera për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë, ndonëse ishin të ndara në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>, **nuk** plotësonin kriteret për sipërfaqen e nevojshme për jetesë për dy persona<sup>8</sup>.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla, që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Çdo dhomë ishte pajsur me orenditë e nevojshme për jetesë si krevat, dyshekë, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

**Në ambientin e paradhomës** është i instaluar një lavaman së bashku me rubinetin e ujit, si dhe tualeti i vendosur në dysheme. Përsa i përket VC-së tek katër dhomat e sigurisë me një person mungonte muri rrethues prej betoni apo tulle të suvatuar në një lartësi 1 m nga sipërfaqja e dyshemesë, sikundër parashikuar në procedurat standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” të Urdhrit nr.1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kreu VIII pika 4.3/b. Ndërsa në dy dhomat e tjera VC konstatohet se ishin sipas procedurës standarte.

Këtë konstatim e ka evidentuar edhe CPT gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri të zhvilluar në periudhën 4-15 Maj 2023 në institucionet policore, në raportin dërguar autoriteteve të Qeverisë së Shqipërisë, përsa i përket kushtet në dhomat e sigurisë), ka konstatuar se: *“Tualetet në Komisariatin e Policisë Fier nuk kishin fare ndarje në kundërshtim me kërkesat e procedurave standarde<sup>9</sup>.*

Përsa më sipër, CPT ka rekomanduar që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm në Komisariate, për të siguruar që tualetet brenda qelisë në qelitë me shumë persona të janë të ndara siç duhet nga pjesa tjetër e qelisë (mundësisht deri në tavan).

Në këtë komisarjat ishte krijuar ambient i posaçëm për larjen e trupit, ku ishte instaluar një dush për larjen e trupit, i cili ndodhej në mes të korridorit të dhomave të sigurisë. Dushi nuk ishte funksional pasi akoma nuk ishte bërë lidhja me ujin e ngrohtë dhe të ftohtë që shërben për këtë qëllim për personat e arrestuar dhe të ndaluar në këtë institucion. Personat në konflikt me ligjin deri tani nuk kanë akses për larjen e trupit në këtë ambient. **Ky është konstatim i përsëritur nga inspektimet e mëparshme të Avokatit të Popullit, i cila bie ndesh me Urdhrin nr. 1720, datë 20.11. 2023 të procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” në të cilën përcaktohet se:** “Brenda sistemit të dhomave të sigurisë

---

<sup>8</sup> Kreu V, pika 3.3 e procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

<sup>9</sup> Kreu VIII, pika 4/ e procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.



ndërtohen dhe funksionojnë ambiente të posaçme që shërbejnë për larjen e trupit të arrestuarve/ndaluarve”.

Numri i këtyre ambienteve (dusheve) është në varësi të kapaciteteve mbajtëse të dhomave të sigurisë dhe nga dinamika që ka në këto ambiente.

Gjithashtu ambientet e sigurisë ishin të pajisura me kaldajë për ngrohjen në dimër, por konstatuam se **kaldaja kishte defekt dhe nuk punonte, pra në këtë komisariat mungonte sistemi i ngrohjes**<sup>10</sup>.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në moment nevojë. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Grupi i inspektimit konstatoi se në këtë **komisariat nuk kishte dhomë mjeku**. Gjithashtu mjeku, ndihmës mjeku apo infermierët nuk ishin pjesë e organikës. Sipas informacionit të marrë nga shefi i shërbimit në dhomat e sigurisë, mjeku thirrej mbi bazë nevojë nga Spitali Rajonal Fier. Numri i lartë i personave të shoqëruar/arrestuar tregon se ka nevojë të domosdoshme për mjek me kohë të plotë. Për vitin 2024 me statusin e arrestuar ishin 276 persona dhe ishin kryer nga mjeku 334 vizita mjekësore. **Edhe ky konstatim është i vazhdueshëm, ndaj mos reagimi ndaj kësaj çështjeje është i papranueshëm**.

Në ambientin e dhomave të sigurisë ndodhej një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore, e cila ishte e monitoruar me sistemin e kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme.

**Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë**. Ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me të dhe ofrohej me shërbim catering.

---

<sup>10</sup>Kreu VIII, pika 3/c e procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, ku parashikohet se: “Kriteret për ndërtimin e dhomave të sigurisë nën dysheme vendosen të gjitha kabllot e tubat e instalimeve të ngrohjes, ato hidraulike dhe ato elektrike, të cilat të jenë të fshehura e të mbuluar me beton. Në rast se nuk është e mundur ngrohja nga dyshemeja, pajisjet për ngrohje të vendosen në paradhomë”.

Nga inspektimi i bërë dhe nga intervista me personat e arrestuar rezultoi se të ndaluarve/arrestuarve nuk u jepen produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Kjo, problematikë që u evidentua gjatë intervistave me të arrestuarit/ndaluarit është në kundërshtim me kërkesat e kërkuara nga Urdhri nr.1720, datë 20.11.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar /ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë kishte 3 persona të arrestuar. Në këtë komisarjat për personat e arrestuar **nuk kishte ambiente për të dalë në ajrim** duke bërë që këto kushte të mos ofrojnë trajtim dinjitoz të personave që kalojnë midis 48 orë në 4-5 ditë në këto ambiente.

Nga intervistat me personat e arrestuar/ndaluar, grupi i inspektimit konstatoi se, ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së arrestimit/ndalimit për ekzekutimin e vendimit të gjykatës apo urdhrin të prokurorit, gjatë shoqërimit në mjedisin e DVP Fier, marrjes në pyetje nga specialistët/oficerët e policisë gjyqësore, si dhe gjatë qëndrimit në dhomat e sigurisë. Të intervistuarit nuk kishin pretendime për trajtim denigrues, jo human, apo për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike ndaj tyre.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në Komisarjatin e Policisë Fier, u evidentua se zbatoheshin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurat standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, ku parashikohet se: *“Çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi e sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës”*.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarjatin e Policisë Fier, *“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”* ishte i tipit *“Model nr.1”* konform me procedurat standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar pjesërisht në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>11</sup>.

Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë.

Avokati i Popullit ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e mbikëqyrjes policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Kjo merr më shumë vlerë pasi ky komisariat shërben edhe si ambient sigurie për komisariatet e tjera që nuk kanë dhoma të tilla.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht në nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe në nenin 109, pika 4 e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Në këtë Komisariat mbahet një regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentohen të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se përgjatë vitit 2024 ishin të shoqëruar 8 të mitur në konflikt me ligjin<sup>12</sup>.

Në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Gjithashtu u evidentuan se mbaheshin edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta me të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe në 8 gjuhë të huaja, të cilat mbaheshin në dhomën e punës dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

---

<sup>11</sup> Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

<sup>12</sup> Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Në këtë komisariat, punonjësit e policisë, të cilët ishin të ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse, zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë. **Nga këqyrja e “Formularit të raportit të shoqërimit ose ndalim/arrestimit”, konstatuam se në këto formularë shoqërimi nuk ishin të plotësuar në të gjitha rubrikat.** Konkretisht nuk ishte plotësuar pika V “Punonjësi i policisë/Patrulla që kreu shoqërimin”, VI “Ambienti/Zona e parë e shoqërimit ose e Ndalim/Arrestimit” dhe VII “Përfundimi i shoqërimit”, të formularëve të raporteve të shoqërimit<sup>13</sup>.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë Fier, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me të shoqëruarit në mjediset e policisë, në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës të ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar<sup>14</sup>.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Kjo problematikë është evidentuar edhe në gjetjet e CPT -së në raport të drejtuar shtetit shqiptar.

---

<sup>13</sup> Procedurat Standarde të Punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894 dt. 19.07. 2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ku përcaktohet se: “a.2.2 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet në dy kopje dhe pasi plotësohet sipas kërkesave dhe rubrikave të parashikuara në të, i dorëzohet punonjësit të shërbimit të informacionit, i cili e kontrollon për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit. a.2.3 – Nëse nga punonjësi i shërbimit të informacionit konstatohen parregullsi në plotësimin ja kthen punonjësit të policisë për ta ri plotësuar dhe njëkohësisht vë në dijen i eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë”.

<sup>14</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.*

*Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.”*

***CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar***<sup>15</sup>.

Grupi i inspektimit, ka evidentuar si një praktikë të mirë në Komisarriatin e Policisë Fier, investimin e realizuar me fonde nga “Save the Children”, për krijimin e tre dhomave të përshtatura për intervistimin, ashtu dhe për qëndrimin e të miturve të arrestuar/ndaluar apo të dënuar, të pajisura me orënditë e nevojshme dhe me kushte të përshtatshme bashkëkohore. Këto dhoma ndodheshin në katin e 1 të godinës së komisarriatit dhe ishin bërë funksionale. Ato ishin të pajisura me të gjitha orënditë e nevojshme si tavolina, kolltukë, bibliotekë për libra, postera informues, si dhe ishte e monitoruar me sistemin audio viziv. Në Komisarriatin e Policisë Fier ishin trajnuar 2 specialistë vetëm për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve, por gjithsesi zbatimi efektiv i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, mbetet ende problem përse megjithëse të trajnuar, ata nuk plotësojnë detyrimet ligjore të caktuara në këtë kod, si regjistrimi i veçantë për të miturit.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në Komisarriatin e Policisë Fier, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

---

<sup>15</sup> Electronic recording of police interviewees (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 3 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të arrestuarit me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

Përgjatë inspektimit në Komisariatin e Policisë Fier, **u konstatua se nuk kishte një listë të afishuar në ambientet e komisarariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, si dhe nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm.** Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

CPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Gjithashtu kërkohet veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. CPT-ja gjatë vizitës në organet e Policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*<sup>16</sup>.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte edhe lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. Pamvarësisht kësaj, në rastet kur i shoqëruari apo i ndaluar/arrestuari ishte i mitur, psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, por edhe në bashkëpunim me Bashkinë dhe Shkollën e Mesme të qytetit në Fier. **Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm**, që në në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisarariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut part-time kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*<sup>17</sup>.

---

<sup>16</sup> <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

<sup>17</sup> Kreu V, pika 7.2 e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet dhe mjekimet e dhëna pasqyrohen në regjistrin e vizitave mjekësore. Në regjistrin e mjekut ishin të evidentuara të gjitha të dhënat e konstatuara përgjatë vizitës mjekësore të personave të arrestuar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e fondeve për riparimin e dritareve të dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Fier, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e murit rrethues të tualeteve në dhomat e sigurisë sipas parashikimeve kreu VIII pika 4.3/b, në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.
3. Marrjen e masave për vendosjen e stolave dhe tavolinave në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientet e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Fier.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisarlatit.
6. Marrjen e masave për emërimin e mjekut me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar, brenda 12 orëve të vendosjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë.

7. Marrjen e masave për krijimin e dhomës së mjekut brenda ambienteve të dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë Fier.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për vënien në funksion të ambientit të dusheve për dhomat e sigurisë në këtë komisarariat.
9. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
10. Marrjen e masave për vënien në funksion të kaldajës për mundësimin e ngrohjes të personave të arrestuar, për periudhën e dimrit në ambientin e dhomave të sigurisë në këtë komisarariat.
11. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të *“Formularit të Raportit të Shoqërimit”* nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, në zbatim të rregullave të përcaktuara në procedurat standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
12. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat kryesisht.
13. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisarariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
14. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin në ambientet e dhomave të sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.
15. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të rubrikës *“Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve”* në *“Regjistrin e personave të shoqëruar”* dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër sipas kërkesave të parashikuara në procedurat standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022 dhe sigurimin e monitorimit të vazhdueshëm të tyre si dhe nisjen e procedurave për evidentimin e përgjegjësve në lidhje me këtë çështje.
16. Marrjen e masave për vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar brenda dhomave të shoqërimit pasi përgjatë kalimit në korridor nuk garantohet leximi dhe kuptimi i tyre nga të shoqëruarit, si dhe vendosjen në ambientet e



komisariatit të posterave me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të shoqëruar/ndaluar, në gjuhë të ndryshme.

17. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar apo ndaluar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.
18. Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve të policisë që janë përgjegjës për persona të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin si dhe njohja me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në Mjedise e Policisë”* .

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI  
i Mekanizmit Kombëtar  
për Parandalimin e Torturës  
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI**